



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prototato Received/Delivery	31.05	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
	4555/2023		1.16	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.671/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.671/2023 të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër masës disiplinore vërejtje të datës 29.03.2023 të shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 31.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.671/2023 e datës 25.04.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. **Anulohet** masa disiplinore "Vërejtje" e datës 29.03.2023 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA ndaj ankuesit.

III. **Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale dhe regjistri përkatës i nëpunësit civil, masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 29.03.2016 në pozitën *Drejtor i Drejtoratit për Zhvillim të Sektorit Privat* në Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA më datë 29.03.2023 përmes emailit zyrtar i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje", me arsyetimin se:.. *për shkak të mos koordinimit me vartësit e tij dhe mos delegim/shpërndarjeve të punës dhe realizimin e aktiviteteve në kohë me qëllim të përmirësimit të performancës në punë. Dhe pas përsëritjes së kërkesave të njëjta më datë 20 mars ku kam kërkuar deri më datë 24 mars t'i përfundon dhe t'i dërgon tek unë thirrjet e përmirësuar të grant skemave, analizimin dhe propozimin konkret për veprimet që duhet ndërmarr mbi iniciimin e themelimit të parkut të biznesit 2 në Drenas, ndërsa më datë 27 mars keni pasur t'i dërgoni termat e referencës për krijimin e tabelës informuese me emra të kompanive që janë të vendosur në park dhe sot më datë 29.mars nuk kam pranuar akoma ju asnjërin aktivitet të kërkuara, kjo qasje e juaja dhe [redacted] vitin e kaluar ka rezultuar me performancë të dobët dhe një të njëjtën po e vazhdoni përsëri...*

Ankuesi, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 29.03.2023, më datë 25.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3797/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa Këshilli më datë 16.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3797/2023 të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen e datës 29.03.2023; Emailin e datës 06.01.2022 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 06.01.2023 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 16.01.2023 nga ankuesi për [redacted]; Emailin e datës 01.01.2023 nga ankuesi për [redacted]; Emailin e datës 10.01.2023 nga ankuesi për [redacted]; Emailin e datës 18.08.2022 nga [redacted] për [redacted] dhe Komuna e Malishevës; Emailin e datës 15.02.2023, 13.02.2023, 03.04.2023 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 03.04.2023 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 28.03.2023 nga ankuesi për [redacted]; Emailin e datës 28.03.2023 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 03.03.2023 nga ankuesi për [redacted]; Emailin e datës 02.03.2023 nga [redacted] për [redacted]; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin i datës 30.10.2023; Planin e punës për vitin 2023; Emailin e datës 16.02.2023 nga ankuesi për [redacted]; Emailin e datës 15.02.2023, 13.02.2023 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 15.02.2023, 09.02.2023 nga [redacted]

ankuesi për Sh.K; Emailin e datës 22.12.2022 nga A.K për Z.D dhe ankuesin; Emailin e datës 19.12.2022, 05.12.2022 nga ankuesi për A.K; Emailin e datës 27.12.2022 nga Z.D për E.J; Emailin e datës 27.12.2022 nga E.J për A.K; Emailin e datës 01.03.2023 nga ankuesi për Z.D; Emailin e datës 24.02.2023 nga Z.D për ankuesin; Emailin e datës 23.02.2023 nga Z.Sh për S.B; Emailin e datës 23.02.2023 nga Z.B për Z.Sh; Emailin e datës 23.02.2023 nga Z.Sh për E.D; Shkresë për prezantimin e strategjisë për zhvillim industrial dhe dialogu me sektorin provat datës 27.03.2023, 29.03.2023; Emailin e datës 29.03.2023 nga ankuesi për Z.D; Emailin e datës 24.03.2023, 21.03.2023 nga A.K për ankuesin; Emailin e datës 16.03.2023 nga ankuesi për A.K; Emailin e datës 28.12.2022 nga A.K për ankuesin; Emailin e datës 22.12.2022 nga A.K për Z.D dhe ankuesin; Emailin e datës 05.12.2022 nga ankuesi për A.K; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 29.03.2016; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën *Drejtor i Drejtoratit për Zhvillim të Sektorit Privat* i datës 24.03.2016; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 08.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 16.05.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin i datës 10.12.2021; Emailin e datës 20.03.2023, 16.03.2023 nga ankuesi për A.K; Emailin e datës 17.03.2023 nga A.K për ankuesin; Emailin e datës 15.09.2022 nga Z.D për ankuesin; Emailin e datës 15.09.2022 nga A.V për L.V; Emailin e datës 15.09.2022, 08.09.2022 nga A.K për L.V; Emailin e datës 13.09.2022 nga A.F për L.V; Emailin e datës 14.09.2022 nga L.I për F.L, F.B dhe F.F; Emailin e datës 09.09.2022 nga F.L për Sh.Q; Emailin e datës 09.09.2022 nga Sh.Q për F.L; Emailin e datës 15.09.2022 nga V.R për Z.D; Emailin e datës 02.02.2022 nga Z.D për A.M dhe ankuesin; Emailin e datës 09.11.2022 nga Z.D për ankuesin dhe A.K; Emailin e datës 09.11.2022 nga ankuesi për A.K; Emailin e datës 02.11.2022 nga A.K për B.A; Emailin e datës 02.11.2022 nga B.A për ankuesin; Emailin e datës 02.11.2022 nga ankuesi për S.Ç, M.B dhe B.A; Emailin e datës 01.11.2022 nga Z.D për B.K dhe ankuesin; Emailin e datës 01.11.2022 nga B.K për Z.D dhe ankuesin; Kërkesë për zhvillimin e procedurave të prokurimit për kontraktimin e OE për Ndërtimin e Infrastrukturës në Parkun Industrial në Opterushë e datës 31.10.2022; Emailin e datës 24.08.2022 nga ankuesi për F.B dhe A.V; Emailin e datës 24.08.2022 nga V.R për ankuesin; Emailin e datës 19.08.2022 nga V.R për Z.D; Emailin e datës 10.11.2022 nga Z.D për ankuesin dhe A.K; Emailin e datës 10.11.2022 nga ankuesi për A.K; Emailin e datës 10.11.2022 nga A.K për ankuesin; Emailin e datës 15.05.2023 nga ankuesi për Z.D.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe duke nxjerrë përfundimin e përgjithshëm mbi bazën e provave si tërësi, konstatoi se janë të bazuar pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "*Vërejtje*" të datës 29.03.2023, pretendon që kjo masë është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike për faktin se të gjitha kërkesat dhe detyrat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës janë përmbushur.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të vlerësimit të kësaj çështje juridike-administrative, lidhur me kualifikimin e shkeljeve disiplinore ju referuar dispozitave të nenit 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "*1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të*

punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbyshja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbyshjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbyshjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjisllacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar”.

Referuar dispozitave të lartcekura si dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore “Vërejtje” e datës 29.03.2023, Kolegji i Këshillit, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës-KIESA në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, masën disiplinore të kontestuar me këtë ankesë e ka shqiptuar duke u thirrur në nenin 28, nenin 45, nenin 46, nenin 47 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 48 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Rrjedhimisht bazuar në këtë Kolegji, vlerëson se masa disiplinore “Vërejtje”, bazuar në legjisllacionin në fuqi të zyrtarëve publik jepet për shkelje të lehta disiplinore që ndërlidhen me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkritazi me këtë mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka arritur të konstatoj në mënyrë konkrete se cilat janë veprimet e ankuesit, konkretisht nuk është konstatuar se shkeljet e supozuara të ankuesit a janë shkelje të rënda disiplinore apo shkelje të lehta, ngase sipas masës disiplinore “Vërejtje” të datës 29.03.2023 të shqiptuar ndaj ankuesit, mund të konkludohet se ankuesi nuk ka bërë veprime që bien ndesh me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit civil, në këtë rast ankuesit, në rast se konstaton se veprimet e nëpunësit civil bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi, fillimisht është i obliguar që të bëjë kualifikimin e shkeljeve disiplinore (a janë shkelje të rënda apo të lehta) dhe të konstatoj në mënyrë të drejtë se cilat dispozita ligjore janë cenuar me veprimet e nëpunësit civil respektivisht ankuesit, ndërsa në rastin konkret të ankuesit mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk ka ndërmarr veprimet e tilla duke bërë kualifikim paushall të shkeljes disiplinore, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të kësaj mase nënkuptohet që e



njëta është shqiptuar për shkak të mospërmbushjes së detyrave të punës e cila nuk konsiderohet shkelje e lehtë.

Duke u bazuar në konstatimet si më lartë, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë ka konstatuar së mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit nuk ka marrë parasysh të gjitha elementet për përcaktimin e drejtë dhe të plotë të përgjegjësisë së ankuesit si dhe parimet për individualizmin e masës disiplinore, sepse sipas aktit të kundërshtuar me ankesë dhe shkresave të lëndës nuk është konfirmuar fakti me prova konkrete të dërguara nga institucioni se nga veprimi i ankuesit të jetë shkaktuar ndonjë pasojë apo dëm për institucionin dhe se përjashtimisht vërejtjes së datës 29.03.2023, me asnjë dëshmi nuk është vërtetuar se ndaj ankuesit më parë ka pasur ndonjë vërejtje të shqiptuar edhe pse një gjë e tillë është kërkuar sipas kërkesës për përgjigje në ankesë të datë 08.05.2023.

Po nga vlerësimi i shkresave të lëndës rrjedhe së ankuesi nuk ka në fuqi ndonjë vërejtje apo masë tjetër disiplinore dhe së i njëjti lidhur me rezultatet në punë për vitin 2022 dhe 2021 është vlerësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për realizimin e objektivave, me notë 4 respektivisht 4.4 apo "shumë mirë", ndërsa për vlerësimin e aftësive është vlerësuar me notë 4.2 respektivisht 4.5 apo *shumë mirë*.

Ndërlidhur me të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se masa disiplinore "Vërejtje" e datës 29.03.2023 e shqiptuar ndaj ankuesit është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht nenit 45 më të cilin është përcaktuar se: "*Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, si dhe nenit 50 paragrafi 1 të njëjtit ligj me të cilin është përcaktuar se: "*1.Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit, dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që e njëjta është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht Udhëheqësi i Njëjesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, është i obliguar që bëjnë heqjen e masës disiplinore ndaj ankueses nga dosja personale e tij.*

Bazuar në nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës "*Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij*

ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin evendimit të Këshillit”.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hy në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.671/2023, datë 31/05/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës-KIESA;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.